



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 19363 Prot

Lezhë, më 06 / 12 /2022

VENDIM

Nr. 123, Datë 02 . 12 .2022

Për përdorimin e Fondit të Kontigjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2022

Në zbatim të nenit 54, të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit Nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

Vendosi :

1.Miratimin e përdorimit të Fondit të Kontigjencës në shumën 224,734 lekë, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2022, për këtë të kryhen veprimet si më poshtë:

- Pakësohet : Gr.00, Prog.01110, Kap.01, Art.609 për shumën 224,734 lekë.
- Shtohet : Gr.00, Prog.09120, Kap.01, Art.231 për shumën 224,734 lekë, fond i cili do të përdoret për bashkëfinancimin e ndërtimit të “Këndit të Lojrave në Shkollën 9 vjeçare ‘M.Gjoni, Rilë’”.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI



Prot 19363/
dt 13.12.22
10 B



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 885/14 Prot.

Lezhë, më 13.12.2022

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut, neni 9, pika 1/1.3, gërma "a", nenin 54, germa "dh" të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" ligjin nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.123, datë 02.12.2022 "Për përdorimin e fondit të kontigjencës, për mbulimin e shpenzimeve të parashikuara në buxhetin e vitit 2022".

P R E F E K T I

Gjergj PRENDI

